



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 dhjetor 2017
Nr. ref.: RK 1172/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI108/17

Parashtrues

SHA “Elektromotori”

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të
Republikës së Kosovës, Ac. nr. 1275/2016, të 7 prillit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është SHA “Elektromotori” me seli në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), që përfaqësohet nga z. Idriz Daci, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin (Ac. nr. 1275/2016, të 7 prillit 2017) të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit).
3. Aktvendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 28 prill 2017.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin ishte refuzuar ankesa e parashtruesit në lidhje me kërkesën e tij për anulimin e procedurës së përmbarrimit kundër ndërmarrjes së tij.
5. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktvendimin e kontestuar, Gjykata e Apelit ka shkelur *“të drejtën e tij për mbrojtjen e pronës”*.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 8 shtator 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 11 shtator 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.
9. Më 18 shtator 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.
10. Më 23 tetor 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Pas përfundimit të procedurës së rregullt gjyqësore lidhur me meritat e rastit, parashtruesi i kërkesës ishte detyruar t’ia paguante një shumë të caktuar të hollash një kreditori. Si rrjedhojë, ishte lëshuar një urdhër përmbarrimi i cili më pas ishte kundërshtuar nga parashtruesi i kërkesës pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë.

12. Më 13 janar 2016, Gjykata Themelore në Gjakovë (Aktvendimi PPP. nr. 176/15) e refuzoi kundërshtimin e parashtruesit të kërkesës për përmbarim, sepse ishte parashtruar jashtë afatit.
13. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë kundër aktvendimit të lartpërmendur në Gjykatën e Apelit.
14. Më 7 prill 2017, Gjykata e Apelit (Aktvendimi Ac. nr. 1275/2016, i 7 prillit 2017) e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës të parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, me arsyetimin e mëposhtëm:

“Gjykata e Apelit ka gjetur se [...] prapësimi [nga parashtruesi i kërkesës] është parashtruar jashtë afatit ligjor prej 7 ditësh dhe se gjykata e shkallës së parë [Gjykata Themelore në Gjakovë] drejtë ka hedhur poshtë kundërshtimin si të paafatshëm [...].”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit ka shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, duke mos aprovuar ankesën e tij të parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë.
16. Rrjedhimisht, parashtruesi kërkon nga Gjykata që ta anulojë aktvendimin e kontestuar dhe ta kthejë çështjen në Gjykatën Themelore në Gjakovë për rigjykim.

Pranueshmëria e kërkesës

17. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të parapara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

19. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...].”

20. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi [...].”

21. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se parashtruesi e ka parashtruar kërkesën e tij më 8 shtator 2017, ndërsa vendimi i kontestuar (Ac. nr. 1275/2016, i 7 prillit 2017) i Gjykatës së Apelit iu dorëzua parashtruesit më 28 prill 2017.
22. Këto fakte tregojnë se parashtruesi e ka parashtruar kërkesën e tij në Gjykatë pas skadimit të afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, siç kërkohet me kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.
23. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor 4 (katër) mujor është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme, dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (Shih rastet e Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut: *Sabri Güneş kundër Turqisë*, nr. 27396/06, GJEDNJ, Aktgjykimi i 29 qershorit 2012, *Idalov kundër Rusisë*, nr. 5826/03, GJEDNJ, Aktgjykimi i 22 majit 2012; *O'LOUGHLIN dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktgjykimi i 25 gushtit 2005; shih gjithashtu rastet e Gjykatës Kushtetuese: Rasti nr. KI175/14, *Sylejman Daut Dibra*, Aktvendimi për papranueshmëri i 25 marsit 2015, rasti nr. KI102/14, *Arben Ademi*, Aktvendimi për papranueshmëri i 22 janarit 2015).
24. Për arsyet e lartcekura, Gjykata konkludon që kërkesa është e paafatshme dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, më 23 tetor 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi